


TË PUNOJMË SOT QË TË MOS




PENDOHEMI NESËR

KRIJIMI DHE EVOLUCIONI I DEMOKRACISË

IDEAL (10), ERDI (11), ALEJNA (10), TUANA (11), BLINI (11), MANJOLLË (11), ERA (10), ART (11)



Këto janë duart tona. Duar që punojnë për demokracinë!



Ne jemi personat përgjegjës për shtetin tonë

A e dini se kur dhe ku është krijuar demokracia? A e dini se si ka ndryshuar ajo? Për këto dhe me shumë, mësoni në artikullin e mëposhtëm

Mirëdita, për juve lexues të artikullit tonë. Siç iu treguam, ne do të flasim për demokracinë. Demokracia u krijua nga qytetarët e Athinës në vitin 507 para erës sonë. Para demokracisë ka ekzistuar autokracia. „Auto“ në shqip do të thotë vetë dhe „kratos“ do të thotë qeverisje. Pra, fjala autokraci do të thotë vetëqeverisje. Ndërsa, fjala demokraci gjithashtu rrjedh nga fjalët greke, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë qeverisje, siç e dini tashmë.

Demokracia ka këto elemente: lirinë, barazinë, respektin, tolerancën, solidaritetin, paqen, etj. Për ne elementi më i rëndësishëm është respekti. Prandaj, do të fillojmë me të. Një shembull i thjeshtë i respektit është atëherë kur ne dëgjojmë dikë i cili/e cila flet. Elementi tjetër i demokracisë për të cilin duam të flasim është barazia.

Fëmijët e Kosovës shkojnë të gjithë në shkollë sepse

ne kemi të drejtën e shkollimit. Shembull tjetër mund të marrim kur ne luajmë, nuk ndahemi vajza dhe djem por luajmë të gjithë së bashku, sepse nuk bëjmë dallime mes njëri-tjetrit.

Demokracia ekziston në dy forma: demokraci përfaqësuese dhe atë direkte. Shteti ynë Kosova ka demokraci përfaqësuese. Kjo do të thotë se qytetarët e Kosovës zgjedhin me vota të lira përfaqësuesit e tyre. Këta përfaqësues, më pas punojnë në dobi të qytetarëve. Gjatë shkrimit të këtij artikulli ne pyetëm veten çfarë do të ndodhte nëse nuk do të kishim demokraci. Së pari, nuk do të kishim elementet e demokracisë që janë të rëndësishme për çdo qytetar. Nuk do t'i kishim të drejtat e barabarta sepse vetëm një person do t'i merrte vendimet dhe mendimi i qytetarëve nuk do të vrente. Dëshirat tona nuk do të dëgjoheshin e as nuk do të plotësoheshin. Askush nuk do të mund të bënte atë që do të dëshironte. Për këto arsye, ne mendojmë se demokracia me të vërtetë është forma më e mirë e qeverisjes.




Një pjesë e ekipit tonë të mahnitshëm



Kurse, ne jemi gazetarët e tjerë të këtij ekipi

VOTO ATË QË DO TI, JO ATË QË DUAN TË TJERËT

EDA (11), NOA (11), ARBESA (11), ALKETA (11), JUNA (12), DIORS (11), KLEST (11), ELTION (11),
RAMIZ (11)



Lexues të nderuar, ne do t'iu tregojmë një rast që lidhet me zgjedhjet dhe votat e lira

Klesti, shoku ynë i klasës, në grupin tonë të punës, tregoi një rast me babain e tij, i cili i kishte ndihmuar një të moshuari gjatë procesit të votimit. Ky rast kishte ndodhur në zgjedhjet e kaluara qendrore që janë mbajtur në shtetin tonë, Kosovë. Derisa babai i shokut tonë dha votën e tij në mënyrë të rregullt, po në të

ati i shokut nuk pranoi të bënte një gjë të tillë, sepse ky akt është kundër sjelljeve që qytetarët e përgjegjshëm i bëjnë dhe që duhet gjithmonë t'i bëjnë.

Duke përdorur këtë rast, ne kuptojmë se secili qytetar e ka të drejtën e votës për personin që mendon se është më i miri dhe i cili i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për t'u bërë një udhëheqës i denjë. Udhëheqësit e denjë do t'i plotësojnë më pas nevojat e qytetarëve.

Për ty lexuesi ynë, nxjerrim një mesazh të nevojshëm. Ndonëse, mund të ndodh që dikush kërkon nga ju të votoni në emrin e tyre, ju mos pranoni asnjëherë. Njashtu sikurse ka vepruar babai i shokut tonë, në rastin me personin e moshuar. Kjo sepse secili ka përgjegjësi të mendoj vetë se për kë duhet të votoj. Vota juaj është simbol i përgjegjësisë që qytetarët e kanë gjatë procesit të zgjedhjes. Andaj, bëhuni edhe ju qytetarë të përgjegjshëm.



Në procesin e votimit ka rend dhe rregulla


njëjtën klasë të votimit, hasi në një të moshuar i cili kërkoi ndihmë nga ai. Personat përgjegjës të procesit të votimit të asaj qendre, e miratuan këtë kërkesë. Por, kjo nuk mbaroi me kaq. I moshuari kërkoi nga babai i shokut tonë, një detyrë mjaft të rëndë që kishte të bënte me papërgjegjësinë e tij si qytetar. Ai kërkoi që të votonte atë që ai donte, sepse paraprakisht nuk e kishte menduar se kë të votonte vetë. Kjo tregon një papërgjegjësi në raport me zgjedhjet qendrore. Por, i



Ne shkruajmë, ju lexoni

KUVENDI MË PËRFAQËSON EDHE MUA

MATIN (11), ERIS (11), ERONIDA (11), VJENDITA (11), SONILA (10), LEJLA (11), GRETA (11), VENIS (11),
TRIUMF (11)



Ne deputetët e vegjël sot diskutuam për Kuvendin dhe rëndësinë e tij. Të gjitha informatat që i morëm sot, i gjeni në këtë artikull

Kuvendi është një ndër institucionet më të rëndësishme në vendin tonë. Janë të shumta arsyet se pse e themi këtë gjë. Së pari, ky institucion zgjedhet direkt nga ana e popullit, dhe është i vetmi institucion shtetëror që zgjedhet në këtë mënyrë. Kuvendi është po ashtu i vetmi institucion që miraton ligje. Këto janë dy arsyet më të rëndësishme që e bëjnë Kuvendin institucionin më unik dhe më të rëndësishëm të vendit tonë. Meqë jemi tek ligjet, ne do t'iu tregojmë për një ligj të fundit që është miratuar e që ndikimi i tij është shumë i madh. E kemi fjalën për ligjin në të cilin thuhet se të gjithë vozitësit e makinave, duhet të kenë ulëse të veçanta për fëmijët e tyre prej moshës 0-12 vjeçare. Pa dyshim që rëndësia e këtij ligji është shumë e madhe, sepse kështu rreziku për aksidente fatale është shumë më i vogël. Pse zgjodhëm të flasim për këtë ligj janë aksidentet e shumta për të cilat kemi dëgjuar kohëve të fundit. Për këtë arsye, ne si fëmijë, por edhe prindërit tanë i janë gëzuar shumë hyrjes në fuqi të këtij ligji. E ligje si këto të cilat kanë për qëllim përmirësimin e jetës sonë kemi në numër të madh. Miratimi i ligjeve është një ndër tre funksionet kryesore të Kuvendit. Kurse, dy të tjerat janë: funksioni përfaqësues dhe ai kontrollues. Edhe këto të dy funksione kanë rëndësi po aq të madhe sa edhe miratimi i

ligjeve. Me funksionin përfaqësues kuptojmë që Kuvendi përfaqëson popullin, sepse është populli ai që i zgjedh deputetët. Ndërsa, funksioni kontrollues ka të bëjë me një detyrë që e ka Kuvendi, e që është mbikëqyrja e punës së Qeverisë. Dikush mund të pyet se pse Qeveria të kontrollohet nga Kuvendi? Arsyeja se pse Kuvendi ushtron funksionin kontrolli ndaj Qeverisë është se ligjet që i përmendëm më herët, që të vijnë deri tek ne qytetarët, së pari duhet të kalojnë në Qeveri. Është ky institucion që e bën të mundur zbatimin e të gjitha ligjeve të miratuara nga Kuvendi. E, mënyra më e mirë për të ditur nëse po zbatohen apo jo është një mbikëqyrje e punës së saj.


Pra, siç po shihet Kuvendi ka rëndësi të madhe tek të gjithë qytetarët, duke ju përfshirë edhe ju të dashur lexues. Por, çka duhet të bëjnë qytetarët që të vlerësojnë punën e Kuvendit, lexojeni faqen tjetër.



Punë, por edhe lumturi përjetuam sot


Për të gjitha të mirat që Kuvendi i bën për ne, ne qytetarët e Kosovës duhet të mundohemi dhe të punojmë për zhvillimin e vendit tonë. Këtë mund ta bëjmë në mënyrë shumë të thjeshtë, në përditshmërinë tonë. Për shembull, kur jemi në shkollë ne iu përmbahemi rregullave të shkollës, të cilat nuk janë bërë pa ndonjë arsye. Ka shumë arsye se pse ekzistojnë ato rregulla. Tani do t'iu tregojmë se pse e bëmë një lidhje mes shkollës dhe Kuvendit. Në Kuvend janë gjithsej 120 deputetë, të cilët punojnë për popullin. Ka raste kur jo të gjithë pajtohen me mendimet e njëri-tjetrit, por që gjithmonë janë të obliguar të respektojnë mendimet

e të tjerëve. Këtë ua mundësojnë rregullat që janë në Kuvend. Pothuajse i njëjti shembull mund të merret edhe për shtëpitë tona. Ndodh që jo të gjithë pajtoheni për një gjë, por asnjëherë nuk e diskriminojmë apo përqeshim mendimin e ndonjërit prej anëtarëve të familjes. Pra, në çdo institucion ka rregulla, e ato rregulla vihen në funksion me miratimin e të gjithë anëtarëve të atij institucioni. Mirëpo, që këto rregulla të zgjasin atëherë duhet edhe punë e përkushtim nga ne. Ky ishte një shembull nga më të thjeshtët që kemi mundur të marrim. Ndoshta nuk ishte më i miri, por sipash nesh është më praktik.




Kalojmë pak tek komunikacioni dhe rregullat që janë vënë për një vozitje sa më të mirë dhe pa aksidente. Po të mos ekzistonin rregullat e komunikacionit, vendi ynë do të ishte shumë më i vogël në numër të qytetarëve sesa është sot. Kjo prapë na kthen tek rëndësia e respektimit të rregullave. Janë disa rregulla që nëse nuk respektohen do të kenë ndikim negativ jo vetëm tek personi që nuk i respekton ato. Kjo sepse gjatë vozitjes mund të hasim në ndonjë kalimtar/e rasti dhe mund t'i rezikohet jeta e tij/saj. Andaj themi se nëse rregullat e komunikacionet nuk respektohen nga të gjithë, pasojat do të jenë shumë më të gjera.

Rëndësi pothuajse të njëjtë ka edhe respektimi i shtegut për biçiklist. Vetëm mendojeni sikur një ditë keni dalur për një shëtitje me biçikleta me disa shoqë. Hapësira e paraparë për biçikleta është zënë me automjete të tjera dhe ju detyroheni të ktheheni. Kjo sepse ka qytetarë të cilët nuk tregohen shumë të përgjegjshëm ndaj përgjegjësive të tyre dhe nuk e respektojnë shtegun për biçiklist.



Ajo çka ne si nxënës kërkojmë nga çdo qytetar është që secili t'i përmbush detyrat që i ka ndaj vendit të vet. Në këtë mënyrë mund t'ia kthejmë Kuvendit të gjithë punën që e bën për ne. A pajtoheni edhe ju me këtë?





IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Selami Hallaqi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-4
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjilan